

Deri te:

Këshilli Mësimor - Shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës

Lënda: Vlerësimi i disertacionit të doktoraturës i kandidates Yllka Cemena me temë:

“Zhvillimi i parametrave antropometrik dhe i aftësive motorike te karateistët dhe nxënësit e moshës 12-14 vjeç”

Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 25. 09. 2024 sollti vendimin: nr.19-113/2, për formimin e Komisionit për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës me titull “Zhvillimi i parametrave antropometrik dhe i aftësive motorike te karateistët dhe nxënësit e moshës 12-14 vjeç” i kandidates Mr. Yllka Cemena. Komisioni përbëhet nga: Prof. Dr. Fadil Rexhepi, anëtar; Prof. Dr. Vullnet Ameti, mentor; Prof. Dr. Fadil Mamuti, anëtar; Prof. Dr. Kastriot Shaqiri, anëtar; Doc. Dr. Alim Hajredini, anëtar.

Ky komision i paraqet Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike këtë:

RAPORT

për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Mr. sc. Yllka Cemena u lind në Dibër në vitin 23.02.1985. Shkollën fillore dhe të mesme i ka mbaruar në Dibër. Në vitin 2006 mbaroi studimet e ciklit të parë – niveli Bachelor, në Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 2009 mbaroi studimet e ciklit të dytë - niveli Master, në Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Prishtinës dhe mori titullin “Master i Kulturës Fizike dhe Sportit”.

Përvoja profesionale:

Yllka Cemena ka punuar si arsimtare e edukatës fizike nga shkurti i vitit 2010 deri në tetor të vitit 2017. Nga tetori i vitit 2017 është punësuar si asistente në Universitetin “NËNË TEREZA” Shkup, ku vazhdon të punojë. Gjatë punës në universitet ka qenë e angazhuar në disa funksione dhe komisione. Në tetor të vitit 2020 emërohet koordinatore e programit studimor

“Sport dhe shkenca sportive” për një periudhë dy vjeçare. Në shkurt të vitit 2022 emërohet “Udhëheqëse e qendrës sportive universitare” me mandat 2 vjeçar. Poashtu ka qenë e angazhuar në disa komisione punuese në fakultet.

Gjatë karrierës së saj, Mr. sc. Yllka Cemena ka qenë aktive në punë kërkimore, ku do të pasqyrohen disa nga punimet shkencore, profesionale dhe prezantimet:

Punime shkencore të publikuara:

“RELATIONS AND SOME CHANGES IN THE MOTOR SKILLS OF YOUNG KARATIST OF DIFFERENT SEXES” Yllka Cemena¹ Vullnet Ameti², Visar Ganiu² & Shpresa Memishi² 2016 International Journal of Sports Sciences and Health SPORT AND HEALTH, Tetovo, 2016.

"AGE AND GENDER DIFFERENCES IN A 4x10 M SHUTTLE RUN TEST FOR PRIMARY SCHOOL CHILDREN AGED 6 TO 14" Bejtulla Emini¹, Agon Saiti ², Seryozha Gontarev², Sedat Baftiu², Yllka Cemena² www.pesh.mk – 2022 Research in physical education,sport and health, Skopje 2022 www.pesh.mk

ANTHROPOMETRIC CHARACTERISTICS AND PHYSICAL FITNESS LEVEL IN RELATION TO BODY WEIGHT STATUS IN SIX-YEAR-OLD MACEDONIAN CHILDREN" Bejtulla Emini¹, Agon Saiti², Seryoza Gontarev², Sedat Baftiu², Yllka Cemena², Skopje 2022 www.pesh.mk – 2022 Research in physical education,sport and health, Skopje 2022

Punime shkencore të prezantuara:

10/12/2021 – 11/12/2021 "THE IMPACT OF TABLE TENNIS GAME ON THE ASYMMETRY OF SOME ANTHROPOMETRIC CHARACTERISTICS AND MOTOR SKILLS OF TABLE TENNIS PLAYERS OF NORTH MACEDONIA COMPETING IN THE SUPER AND FIRST NATIONAL LEAGUE"

INTERNATIONAL CONFERENCE IN SPORTS SCIENCE, Prishtina 10.12.2021-11.12.2021 THE FACULTY OF PHYSICAL CULTURE AND SPORTS,AAB COLLEGE,KOSOVO Agon saiti¹, Vladimir Vuksanovikj², Yllka Cemena², Artan Nika²

27/05/2016 – 28/05/2016 “RELATIONS AND SOME CHANGES IN THE MOTOR SKILLS OF YOUNG KARATIST OF DIFFERENT SEXES” Yllka Cemena¹ Vullnet Ameti², Visar Ganiu² & Shpresa Memishi²

THIRD INTERNATIONAL BALKAN CONFERENCE IN SPORT SCIENCES, IBCSS2016, May 27-28. 2016 State University of Tetova, Tetova, Macedonia Yllka Cemena¹ Vullnet Ameti², Visar Ganiu² & Shpresa Memishi²

05/05/2017 – 06/05/2017 “THE DIFFERENCE BETWEEN MOTORIC ABILITIES AND MORPHOLOGIC PARAMETERS UPON BEGINNER LEVEL KARATE STUDENTS UNDER A THREE-MONTH PROGRAM”

FOURTH INTERNATIONAL BALKAN CONFERENCE IN SPORT SCIENCES, IBCSS2017, May 05-06, 2017, Tetova, Macedonia Yllka Cemenal Vullnet Ameti², Visar Ganiu² & Shpresa Memishi

Në vitin 2015 regjistroi studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës në Fakultetin e Kulturës Fizike - drejtimi kineziologji, Në vitin 2024 pasi i ka dhënë të gjitha provimet, ka përgatitur projektin e temës së disertacionit të doktoraturës me temën “Zhvillimi i parametrave antropometrik dhe i aftësive motorike te karateistët dhe nxënësit e moshës 12-14 vjeç”, me mentor, Prof. Dr. Vullnet Ameti.

Punimi i doktoraturës është i shtypur në 113 (njëqindë e trembëdhjetë) faqe. Teksti është i ndarë në: 8 (tetë) kapituj, 12 (dymbëdhjetë) nën kapituj, përmban 44 (dyzetë e katër) tabela, 20 (njëzetë) grafiqe dhe 39 (tridhjetë e nëntë) njësi bibliografike.

Lëndë e këtij hulumtimi janë sportistët e karatesë dhe nxënësit e moshës 12-14 vjeç, përkatësisht matja e disa karakteristikave antropometrike dhe aftësive motorike në fillim të vlerësimit (matjet iniciale), të moshës 12,13 vjeç, ndërsa vlerësimi final (matjet finale) pas një viti (mosha 13,14 vjeç).

Ky punim paraqet një kontribut modest për këtë fushë kërkimore, sepse rritja e fëmijëve dhe zhvillimi i tyre motorik ndryshon gjatë moshës së re, e sidomos te fëmijët që krahas edukimit fizik në shkollë, zhvillojnë edhe aktivitet të rregullt sportiv. Fëmijët, gjatë jetës së tyre, kalojnë nëpër faza me veçori zhvillimore të dimensioneve të ndryshme të statusit antropologjik si aftësitë dhe karakteristikat kognitive, konative, funksionale, anatomike, fiziologjike etj, si dhe aftësitë motorike. Përcjellja, analiza dhe njohja e mirë e karakteristikave antropometrike dhe aftësive motorike nëpër këto faza të ndryshme zhvillimore, është shumë e rëndësishme për zhvillimin dhe rritjen e drejtë të nxënësve, ndërsa te sportistët ndihmon në përmirësimin e performansave dhe të arriturve sportive. Duke i pasur parasysh këto të dhëna, si qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është parashtruar vërtetimi i ndryshimeve zhvillimore të karakteristikave antropometrike dhe aftësive motorike te nxënësit dhe karateistët e moshës 12 gjer më 14 vjeç.

Në Hyrje të këtij punimi, autorja shpjegon rëndësinë e sportit të karatesë, ndikimet e aftësive motorike te trupi i fëmijëve dhe përcaktimi i treguesve kryesor antropometrik. Karateja

është sport që bën pjesë në artet marciale, mëson teknikat e mbrojtjes dhe të sulmit pa armë. Disiplina dhe aftësimi i fëmijëve apo të rriturëve, gjatë të ushtruarit karate e bën këtë sport mjaft popullor. Në aspekt shëndetsor ky sport sjell shumë dobi, ashtu që shumë studiuesë të ushtruarit e definojnë si: 'Ushtrim fizik i tërë trupit, i cili vihet në lëvizje mendërisht dhe fizikisht, ndihmon punën e mushkërive, përmirëson përbërjen e gjakut, e bën trupin të fuqishëm dhe rrit marrjen e oksigjenit, sjell gjumë të mirë dhe eliminon pagjumësinë, krijon shkathtësi, reflekse dhe shpejtësi ekzekutimi, stërvitja poashtu shërben për të normalizuar masën e trupit.

Grupmoshat 12 deri 14 vjeç janë pjesë e adoleshencës gjatë së cilës ndodhin ndryshime të mëdha trupore. Në këtë periudhë përgatitja bazë dhe speciale sigurohet nëpërmjet mjeteve dhe detyrave specifike për drejtime të përcaktuara sportive. Përgatitja sportive shumëvjeçare nënkupton periudhën e të ushtruarit nga fillimi i të marrurit me karate deri në garimin e fundit. Kjo periudhë më së shpeshti zgjatë 15 vjet, me fillim optimal të të ushtruarit (11-12 vjet) si dhe me të gjitha kushtet objektive dhe subjektive për mbarëvajtjen e procesit stërvitor.

Ndikimi i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm rregullojnë zhvillimin, sjelljen dhe karakteristikat e një personi. Aktiviteti fizik dhe edukimi i rregullt si faktorë të jashtëm mund të përmirësojnë pak a shumë karakteristikat e zhvillimit të një individi të caktuar. Shkalla e këtyre ndryshimeve përcaktohet nga potencialet e ndryshme biologjike të individit dhe ligjet e zhvillimit të një periudhe të caktuar të rritjes, të cilat janë të ndryshme në çdo moshë dhe gjini. Nga hulumtimet e bëra është vërtetuar se zhvillimi i disa karakteristikave morfologjike në radhë të parë përcaktohet nga faktorët endogjen, veçanërisht faktorët trashëgues në masë dukshëm më të vogël, në krahsim me faktorët ekzogjen, që kanë ndikim më të madhë. Përmes aftësive motorike, arrihet efikasiteti lëvizor, që mundëson zgjidhjen e shumë problemeve komplekse të lëvizjes. Aktivitetet lëvizore kërkojnë energji të caktuar dhe kohëzgjatje të ndryshme, shpejtësi të ekzekutimit, trajektore të ndryshme të lëvizjes, etj.

Aftësitë motorike janë individuale dhe mund të rritjen si rezultat i angazhimit të plotë të një personi - mendërisht dhe fizikisht. Ato nuk ndodhin veçmas, ato varen nga karakteristikat e lindura dhe aftësitë e fituara. Aftësitë motorike shpjegojnë ndryshimet mes njerëzve dhe ndryshojnë nën ndikimin e ushtrimeve sistematike. Gjatë aktivitetit fizik të njeriut kombinohen cilësitë fizike, proceset biokimike dhe ndryshimet funksionale, ndërkaq aftësitë motorike janë mjet përmes të cilave njeriu komunikon me mjedisin e tij. Shumica e aftësive motorike maten në

mënyrë indirekte me instrumente të ndryshme matëse. Antropometria është pjesë e antropologjisë që ka metoda për matjen dhe hulumtimin e trupit të njeriut dhe me marrëdhëniet mes madhësisë së trupit dhe pjesëve të caktuara të tij. Rëndësia e këtij punimi qëndron në atë se theksohen aftësitë motorike dhe parametrat antropometrik të karateistëve të moshave të caktuara dhe del në pah dobia e karatesë.

Qëllimi i hulumtimit është bazuar në problemin dhe lëndën e hulumtimit ku janë parashtruar disa objektiva konkrete. Në radhë të parë autorja ka vërtetuar dallimet dhe sinjifikancën statistikore të tyre në parametrat antropometrik dhe aftësitë motorike të nxënësve mes matjeve fillestare dhe përfundimtare. Poashtu janë vërtetuar dallimet dhe domethëniet e tyre statistikore në parametrat antropometrik dhe testet motorike të karateistëve mes matjeve fillestare dhe përfundimtare, si dhe vërtetimi i dallimeve dhe sinjifikancës së tyre statistikore për nxënësve dhe karateistët në parametrat antropometrik dhe aftësitë motorike mes matjeve fillestare dhe përfundimtare. Objektiva të tjera të studimit janë: vërtetimi i strukturës latente të variablave motorike dhe variablave antropometrike në fillim dhe në fund të matjeve e poashtu vërtetimin e korelacioneve në fillim dhe në fund të matjeve.

Duke u mbështetur në qëllimet e studimit, janë shtruar **Hipotezat themelore**, për matjen e parë dhe matjen e dytë të karateistëve dhe nxënësve të shkollave.

Pjesa e punimit, **Rëndësia teorike e studimit**, cek momentet kryesore të shtjellimit të problematikës së trajtuar në studim, për gjendjen e treguesëve motorik dhe antropometrik të nxënësve dhe karatesitëve. Hulumtimi ka rëndësi praktike për njohuri konkrete të parametrat antropometrik dhe aftësitë motorike si për fëmijët të cilët e ushtrojnë këtë sport, poashtu edhe për fëmijët që nuk e ushtrojnë sportin e karatesë. Ky punim do shërbejë edhe për specialistët të cilët janë të orientuar të ushtrojnë sportin e karatesë, si hulumtim shkencor se si ndikon ky sport të fëmijët e kësaj moshe. Punimi në përbërjen e tij shpjegon disa nga elementët kryesor të aftësive të një sportisti të karatesë, parametrat antropometrik dhe aftësitë motorike. Në këtë hulumtim janë përfshirë 110 fëmijë karateistë dhe jokarateistë të disa klubeve nga Maqedonia e Veriut, të moshës 12-14 vjeç. Hulumtimi ka karakter longitudinal ku koha e matjes është e një periudhe 1 vjeçare. Mostra e ndryshoreve përbëhet prej 21 testeve në aftësitë motorike dhe 15 matje antropometrike. Ky studim do jetë si një referim edhe për studiuesit e tjerë të problematikës së njëjtë, duke vërtetuar gjendjen e kësaj kategorie të fëmijëve.

Në një pjesë të punimit janë pasqyruar disa studime që kanë të bëjnë me çështjet e lidhura ngushtë me lëndën e këtij hulumtimi, me theks të veçantë të aftësive motorike dhe parametrat antropometrik.

Metodat e përpunimit të të dhënave të këtij studimi mundësojnë kondensimin dhe transformimin e informacioneve bazë, plotësimin e objektivave, si dhe kontrollimin e vlefshmërisë së hipotezave. Metodat e zgjedhura që janë zbatuar në hulumtim janë standarde që përdoren në studimet e kësaj natyre me specifikat përkatëse. Gjatë zbatimit të metodave me të cilat u përpunuan të dhënat bazë të këtij hulumtimi, mundësuan që rezultatet dhe konkluzionet e fituara të kuptohen, interpretohen dhe zbatohen në mënyrë relativisht të thjeshtë, si në kërkimin shkencor ashtu edhe në praktikën pedagogjike. Për të gjitha variablat janë përcaktuar parametrat themelor statistikor qendror, të variabilitetit dhe treguesit e shpërndarjes së rezultateve sikurse: mesi aritmetik, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variabilitetit etj. Dallimet në matjet antropometrike dhe testet motorike në dy grupet e të anketuarve në matjet fillestare dhe përfundimtare u përcaktuan me metodën e T-testit. Dallimet në matjet antropometrike dhe testet motorike të nxënësit dhe karateistët në matjen fillestare dhe në matjen përfundimtare u përcaktuan me analizën e variansës njëfaktorëshe multivariate dhe univariate (MANOVA dhe ANOVA).

Struktura latente e dy grupeve të trajtuara në matjen fillestare dhe përfundimtare të çdo variable të sistemit u përcaktua me metodën Hotelling të komponentëve kryesorë. Numri i komponentëve kryesorë sinjifikant u përcaktua sipas kriterit Kaiser-Guttman. Komponentët kryesorë statistikisht domethënës, në procedurën e mëtejshme, u shndërruan në pozicionin Varimaks. Korrelacioni ndërmjet parametrave antropometrik dhe testeve motorike u përcaktuan me korrelacionin e Pearson-it. Të dhënat janë përpunuar me programet statistikore softuerike SPSS 26.0 (SPSS, v. 26.0 për Windows; SPSS Inc., Chicago, IL, USA) dhe STATISTICA 13.

Në kapitullin e metodave poashtu janë përshkruar hollësisht procedurat që janë përdorur për të mbledhur të dhënat nga hapësira motorike dhe antropometrike. Kushtet e matjeve që janë kryer në këtë studim kanë qenë standarde dhe janë zhvilluar në shkollë gjatë orëve të rregullta të edukimit fizik dhe shëndetësor. Matjet janë bërë nga mësuesë të edukimit fizik, të cilët më parë janë trajnuar. Kushtet e ambientit kanë qenë optimale dhe koha e matjes ka qenë orari i punës së paraditës, nga ora 7:30 deri në orën 14:30.

Instrumentet e matjeve kanë qenë standarde dhe të kalibruara siç duhet përpara përdorimit të tyre. Hapsirat në të cilat janë kryer matjet janë të pastërta, mjaft të ngrohta dhe me ndriçim të mjaftueshëm. Gjatë matjes, të testuarit ishin zbatuar dhe të veshur minimalisht me pajisje sportive. Të gjitha masat antropometrike janë matur sipas udhëzimeve të Programit Biologjik Ndërkombëtar (Lohman, Roche & Martorell, 1988). Instrumentet matëse janë të konstruksionit standard.

Në kapitullin e **analizës dhe diskutimit** të rezultateve të studimit autorja ka pasqyruar tabelat e rezultateve, grafiqet dhe të dhënat e tjera të studimit. Meqenëse në literaturën kërkimore shkencore, ka një numër të konsiderueshëm studimesh që synojnë të shqyrtojnë dallimet në masat antropometrike e aftësitë motorike të njerëzve që merren me ndonjë aktivitet fizik të organizuar dhe njerëzve që nuk merren me të, janë krahasuar dhe janë përdorë si referim i rezultateve të këtij studimi. Nga rezultatet e marra në hulumtim mund të konstatojmë se ndërmjet matjes fillestare dhe përfundimtare të nxënësit ka pasur rritje të masës trupore, lartësisë së trupit, gjatësisë së krahëve, shtrirjes së krahëve, gjatësisë së këmbës, gjatësisë së shputës, perimetrit të pjesës së sipërme të krahut (i relaksuar), perimetrit të pjesës së sipërme të krahut (i kontraktuar), perimetrit të parakrahut, perimetrit të kraharorit e vlera në rritje të matjeve antropometrike të përqindjes së yndyrës së barkut dhe përqindjes së yndyrës në trup. Kurse te karateistët ndërmjet matjes fillestare dhe përfundimtare, ka pasur rritje në masën e trupit, lartësinë e trupit, gjatësinë e krahut, shtrirjen e krahëve, gjatësinë e këmbës, gjatësinë e shputës, perimetrit të pjesës së sipërme të krahut (i relaksuar), perimetrit të pjesës së sipërme të krahut (i kontraktuar), perimetrit të parakrahut, perimetrit të gjoksit e rritje të vlerave të masave antropometrike të indit dhjamor të barkut, indit dhjamor të krahut (triceps) dhe përqindjes së yndyrës së trupit.

Rezultatet e studimit kanë treguar se në matjen fillestare dhe përfundimtare nuk u përcaktuan dallime domethënëse statistikore mes nxënësve dhe karateistëve në asnjë masë antropometrike. Ndryshimet ndërmjet matjes së parë dhe të dytë në matjet antropometrike në të

dy grupet, ka shumë të ngjarë të jenë për shkak të ndryshimeve biologjike të zhvillimit që janë veçanërisht të theksuara në këtë periudhë dhe pjesërisht janë rezultat i faktorëve mjedisor (aktiviteti fizik, statusi socio-ekonomik, stili i jetesës, etj). Në mesin e nxënësve ndërmjet matjeve fillestare dhe përfundimtare, ka pasur një përmirësim të rezultateve në testet motorike për vlerësimin e forcës shpërthyese, shpejtësinë e vrapimit etj. Te karateistët ndërmjet matjes fillestare dhe të fundit përfundimtare, pati përmirësim në rezultatet e testeve motorike për vlerësimin e forcës shpërthyese, në testet e forcës përsëritëse, në testet për vlerësimin e shpejtësisë frekvente të lëvizjeve etj.

Rezultatet e këtij studimi treguan se në matjen fillestare sportistët e karatesë tregojnë rezultate më të mira në testet motorike të koordinimit dhe përkulshmërisë. Në matjen përfundimtare, karateistët treguan rezultate më të mira në testet motorike të forcës përsëritëse, koordinimit, përkulshmërisë dhe ekuilibrit.

Në të dy grupet (nxënësit dhe karateistët) në matjen fillestare dhe në matjen përfundimtare duke faktorizuar masat antropometrike janë marrë dy dimensione latente të cilat mund të identifikohen si: dimensionaliteti gjatësor i skeletit dhe dimensionaliteti rrethor (vëllimi dhe masa) i skeletit dhe indi dhjamor nën-lëkuror.

Te nxënësit, në matjen fillestare dhe përfundimtare me faktorizimin e testeve motorike, u morën shtatë faktorë, por ata ndryshonin nga modeli hipotetik që u përcaktua në këtë punim, pra nuk u fitua struktura përcaktuar qartë e faktorëve në hapësirën motorike. Te disa faktorë të caktuar projektionet kanë pasur më shumë teste motorike, ndërsa te faktorët e tjerë projektionet kanë pasur numër më të vogël të testeve motorike dhe në faktorët e tretë projektionet kanë pasur vetëm një test motorik. Te karateistët, në matjen fillestare u izoluan shtatë faktorë motorikë, ndërsa në matjen përfundimtare u izoluan gjashtë faktorë motorikë.

Rezultatet e hulumtimit treguan se në të dy grupet dhe në të dy matjet (e para dhe e dyta) janë përcaktuar një numër i madh koeficientesh të korrelacioneve statistikore domethënëse ndërmjet masave antropometrike dhe testeve motorike. Karakteristikat antropometrike të fytyrësve të moshës shkollorë janë shumë të rëndësishme për realizimin e strukturave motorike që përfaqësojnë një bazë reale biomekanike qoftë si faktorë që e lehtësojnë ose si faktorë që e vështirësojnë kryerjen e detyrave motorike.

Zhvillimi i arritjeve sportive në karate kërkon vazhdimisht mjete dhe metoda të reja në punën me karateistët e rinj. Për këtë, duhet punuar në përcaktimin e fazave bazë shumvjeçare të

stërvitjes dhe fokusimin racional në secilën prej tyre, si dhe në mënyrën e zhvillimit të karakteristikave fizike. Është e nevojshme të përcaktohet ndikimi i praktikës së karatesë në rritjen dhe zhvillimin korrekt të karateistëve të rinj, të zhvillohen metoda të orientimit dhe përzgjedhjes dhe metoda të caktuara të punës me të rinj të moshave të ndryshme dhe me cilësi sportive të ndryshme. Përcaktimi i dimensioneve antropometrike, motorike, situacionale - motorike, funksionale, kognitive është një faktor i rëndësishëm në procesin e përzgjedhjes sportive dhe krijimit të modeleve në bazë të të cilave programohet procesi stërvitor në karate.

Në kapitullin e **Përfundimit** të punimit, janë rradhitur momentet kryesore që kanë dalë nga analiza e rezultateve të studimit dhe vërtetimi i hipotezave të shtruara në studim, ku mund të vepojnë:

Te nxënësit, ndërmjet matjes fillestare dhe përfundimtare, janë përcaktuar dallime me domethënie statistikore në matjet antropometrike si: masa e trupit, lartësia e trupit, gjatësitë e segmenteve të trupit, perimetrat e gjymtyrëve të trupit dhe të trungut, përqindjet e dhjamit nënlekuoror etj. Dallime domethënëse statistikore ndërmjet matjes fillestare dhe përfundimtare janë vërtetuar në disa teste motorike të forcës shpërthyesë, koordinimit, ekuilibrit etj.

Te karateistët, ndërmjet matjes fillestare dhe përfundimtare, janë përcaktuar dallime domethënëse statistikore në matjet antropometrike si: masa e trupit, lartësia e trupit, gjatësitë e gjymtyrëve të trupit, perimetrat e trungut dhe gjymtyrëve të trupit, e poashtu edhe të indeve dijenore nënlekuore. Në pjesën më të madhe të testeve motorike janë vërtetuar dallime domethënëse statistikore në mes të matjes fillestare dhe përfundimtare.

Por, nga ana tjetër nuk janë përcaktuar dallime domethënëse statistikore te asnjë masë antropometrike mes nxënësve dhe karateistëve në matjen fillestare përderisa mes nxënësve dhe karateistëve në matjen fillestare, janë përcaktuar dallime me domethënie statistikore në disa teste motorike të koordinimit dhe përkulshmërisë. Poashtu nuk u përcaktuan dallime domethënëse statistikore në asnjë masë antropometrike mes nxënësve dhe karateistëve në matjen përfundimtare. Mes nxënësve dhe karateistëve, në matjen përfundimtare, u përcaktuan dallime domethënëse statistikore në disa teste motorike të forcës, koordinimit, përkulshmërisë dhe ekuilibrit.

Në studim është vërtetuar se masat antropometrike të aplikuara te nxënësit në matjen fillestare kanë formuar dy komponentë kryesorë që shpjegojnë variancë totale të lartë (85.21%) të të gjithë sistemit, ku dimensionin i parë latent është identifikuar si dimensionin i masës, vëllimit

të trupit dhe indit dhjamor nënlëkuror, përderisa dimensionimi i dytë latent mund të identifikohet si dimensionaliteti gjatësor i skeletit. Analiza faktoriale e përmasave të trupit të aplikuara te nxënësit në matjen përfundimtare jep informatë për formimin e 2 komponenteve kryesore që shpjegojnë variancën totale të të gjithë sistemit me përqindje të lartë (85,74%). Edhe në këtë rast dimensionimi i parë latent është identifikuar si dimensionimi i masës, vëllimit të trupit dhe indit dhjamor nënlëkuror, ndërkaq dimensionimi i dytë latent është identifikuar si dimensionaliteti gjatësor i skeletit.

Analiza faktoriale e testeve motorike të aplikuara te nxënësit në matjen fillestare ka vërtetuar disa dimensione latente me shpjegueshmëri të lartë të variacionit të sistemit. Situata e ngjashme është edhe me matjet përfundimtare. Për testet motorike të aplikuara te karateistët në matjen fillestare e poashtu edhe në matjen përfundimtare janë formuar dimensione të korreleueshme latente, të cilat shpjegojnë variacionin e sistemit me përqindje të lartë.

Nga analiza e matricës së korrelacionit, shihet se në të dy grupet e entiteteve edhe në matjen fillestare edhe në atë përfundimtare, një numër i madh i koeficientëve të korrelacionit janë në marrëdhënie statistikisht domethënëse dhe të larta, të tjerët janë në marrëdhënie mesatare kurse një numër më i vogël i masave antropometrike dhe testeve motorike kanë korrelacione të papërfundshme.

Në kapitullin e **Literaturës**, janë radhitur referencat e shfrytëzuara për kompletimin e këtij studimi. Referencat e përdorura janë nga studiuesë të fushës së njëjtë hulumtuese. Në këtë pjesë janë pasqyruar gjithsej 39 burime në lidhje me problematikën e studimit. Referencat janë nga autorë të vendit dhe të huaj.

MENDIM DHE PROPOZIM NGA KOMISIONI

Punimi i disertacionit të doktoraturës me temë **“Zhvillimi i parametrave antropometrik dhe i aftësive motorike te karateistët dhe nxënësit e moshës 12-14 vjeç”** i kandidatës Mr. Sc. Yllka Cemena, paraqet studim të dobishëm nga fusha e hulumtimeve shkencore për aftësitë motorike dhe treguesit morfologjik në sportin e karatesë.

Rezultatet e këtij hulumtimi pasurojnë fondin e njohurive shkencore për sportin e karatesë te moshat e reja. Hulumtimet e tilla dhe të ngjashme me to, vërtetojnë se ndikimi i sportit në shëndetin e të rinjve është i lartë dhe me vlera për jetën shoqërore. Po ashtu kontributi shkencor i këtij hulumtimi jep njohuri të dobishme rreth aftësive motorike dhe parametrave antropometrik te fëmijët që merren me sportin e karatesë. Meqenëse studimet e këtyre problematikave në këto hapësira, e sidomos ne vendin tonë janë në numër të vogël, mendojmë se ky studim ka rëndësi për këtë fushë kërkimore. Me këtë hulumtim pasurohen njohuritë mbi procesin stërvitor dhe zhvillimin e aftësive të përgjithshme në sportin e karatesë.

Për arsyet si më lart, Komisioni i vlerësimit të punimit të disertacionit të doktoraturës me titull **“Zhvillimi i parametrave antropometrik dhe i aftësive motorike te karateistët dhe nxënësit e moshës 12-14 vjeç”** i kandidatës Mr. sc. Yllka Cemena, përfundon se punimi i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara dhe i propozon Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike që të miratohet ky raport i vlerësimit të punimit të disertacionit të doktoraturës.

Tetovë, 04.11.2024

Komisioni:

1. Prof. Dr. Fadil Rexhepi – anëtar
2. Prof. Dr. Vullnet Ameti – mentor
3. Prof. Dr. Fadil Mamuti – anëtar
4. Prof. Dr. Kastriot Shaqiri – anëtar
5. Doc. Dr. Alim Hajredini – anëtar

